

URDHËR
Nr. 53, datë 13.3.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, z. Elird Qëndro, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për prokurimet e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, të dala në bazë dhe për zbatim të procedurave përkatëse.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2017.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse z. Elird Qëndro.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Blendi Klosi